**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë**

Datë 11.06.2026

# RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2026**

**Baza ligjore:**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të Ligjit 57/2020, "Për pyjet", Ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligjit nr. 45/2019, datë 18.7.2019 "Për Mbrojtjen Civile", Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar, Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" (ndryshuar me Ligjin nr.69/2013, datë 14.2.2013; nr. 131/2014, datë 2.10.2014; nr. 68/2023, datë 21.7.2023), VKM -së nr.807, datë 28.12.2023 "Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile", VKM-së nr.1080, datë 22.12.2010 "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota", VKM -së nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Bashkisë Durrës" e ndryshuar me VKM-në nr. 134, datë 03.03.2021, Urdhërit nr.417, datë 25.10.2024 "Për ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile", i ndryshuar, VKM nr.60, datë 26.1.2022 "Për shpalljen e ekosistemeve natyrore rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria iv), si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie".

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër** *(Çfarë propozohet në projektvendim)*:

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota të bashkisë Durrës për vitin 2026 sipas dokumentacionit bashkalidhur miratuar nga titullari i institucionit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH) pranë Bashkisë Durrës, Komisioni i Mbrojtjes Civile dhe Njësitë Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

Fonde të buxhetit të shtetit dhe buxhetit të bashkisë Durrës.

**Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtja Civile

**Impakti social/grupet që preken:**

Banorët e Bashkisë Durrës.

**A është objekt konsultimi:** *(PO/JO)*

*PO konsultimi është bërë me datë 25.05.2026 . Pas rekomanimeve Drejtoria përkatëse ka dhënë argumetat e saj që janë përfshirë dhe në plan.*

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë, u mblodhë më datë 11.06.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 9 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Pika nr. 9 u hap për diskutim.

Pyetën këshilltarët nese kanë ndonjë paqartësi ose kanë nevojë për sqarim.

Të folle janë dakord me dokumentacionin për atë paraqitur.

Kjo pikë të kalojë për shqyrtim në mbledhjen e KB.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:**

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim

b- Miratimin e projekt aktit

c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
e- ____________________________________

**Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Kryetar | Mirela Shala |
| 2 | Zv/Kryetar | Xhiliola Doçi |
| 3 | Sekretar | Zhuljeta Ngota |
| 4 | Anëtar | Rolant Xhelilaj |
| 5 | Anëtar | Ervis Bekteshi |